

Pasqyra e Pozicionit financiar


AKTIVE	Shenime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Aktivitet afatshkurtra			
Aktivitet monetare			
<i>Llogari rrjedhse bankare</i>		143,390,873	
<i>Arke</i>		-	
Totali I Aktiveve monetare	4	143,390,873	
Investime			
Të drejta të arkëtueshme			
<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>		9,556,494	
<i>Tvsh kreditore</i>			
<i>Tatim fitimi I mbipaguar</i>			
<i>Te tjera</i>		661,329	
Totali I te drejtave te arketueshme	5	10,217,823	
Inventarët			
<i>Lende e pare dhe materiale te kosumueshme</i>		782,603	
<i>Gjysme produkte</i>			
<i>Produkte te gatshme</i>			
Totali I inventarit	6	782,603	
Shpenzime të shtyra			
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara			
Totali I aktiveve afatshkurtra		154,391,299	
Aktive afatgjata			
Aktive financiare			
Aktivitet materiale			
<i>Toke dhe Ndertesa</i>		156,677,088	
<i>Makineri e pajisje</i>		668,562,790	
<i>Pajisje zyre te marre si grand</i>		14,642,647	
<i>Inventar ekonomik</i>		587,361	
<i>Asete ne magazine</i>		288,315	
Totali I aktiveve materiale	7	840,758,201	
Aktivitet biologjike			
Aktivitet jo materiale			
<i>Licenc programi dhe transmetimi</i>		2,987,348	
Aktive jo materiale:	8	2,987,348	
Aktive tatimore të shtyra			
Kapitali i nënshkruar i papaguar		-	
Totali I aktiveve afatgjata		843,745,549	
Total Aktive		998,136,848	

Shefe Fiance



Rita Mishtaku

Drejtor Finance



Olsi Shahini

Administratori



Pasqyra e Pozicionit financiar

PASIV	Shenime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Detyrime afatshkurtra:			
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>		9,313,907	
<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		8,117,388	
<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>		779,469	
<i>Te tjera detyrime</i>		147,462,430	
Shuma detyrime afatshkurtra	9	165,673,194	
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara Grande dhe të ardhura të shtyra:			
<i>Asete të dhuruara</i>		16,691,002	
<i>Dhurim likuiditetesh për rikonstruksion zyresh në Fier</i>		82,435,320	
Total grande të marra		99,126,322	
Provizione		-	
Total detyrime afatshkurtra		264,799,516	
Detyrime afatgjata:			
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	
Të ardhura të shtyra		-	
Provizione		-	
Detyrime tatimore të shtyra		-	
Total detyrime afatgjata	10	-	
Total detyrime		264,799,516	
Kapitali dhe Rezervat			
<i>Kapitali i Nënshkruar</i>		359,068,000	
<i>Prime me kapitalin (Diferenca e pa kaluar në kapital në krijimin e shoqërisë)</i>		468,729,158	
<i>Rezerva ligjore</i>			
<i>Rezerva për investime</i>			
<i>Rezerva të tjera</i>			
<i>Fitim / Humbja e Vitit</i>		(94,459,826)	
Total kapitali aksionar	11	733,337,332	
Totali I kapitalit dhe I detyrimeve		998,136,848	

Shëfë Fjance

Rita Mishtaku

Drejtor Fjance

Olsi Shahini

Administratori

Genci ÇIPI



Pasqyra e performances	Shenime	06 janar-31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	12	19,208,475	
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		-	
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	13	(1,983,955)	-
<i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>		(1,931,443)	
<i>Të tjera shpenzime (konsumi i inventarit të imet)</i>		(52,512)	
Shpenzime të personelit	14	(92,821,412)	-
<i>Paga dhe shpërblime</i>		(81,671,006)	
<i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		(10,481,260)	
<i>Shpenzime të tjera për personelin</i>		(669,146)	
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale			-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	15	(2,366,076)	
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	16	(16,433,080)	
<i>Shpenzime të tjera me fatura tatimore</i>		(12,961,574)	
<i>Shpenzime për dieta , keshill mbikqyres e komisjone</i>		(3,471,506)	
Të ardhura të tjera	17	342,233	-
<i>Rimarje Grandesh nga amortizimi I asetve</i>		199,152	
<i>Rimarje Grandesh për konsumin e materialeve të falaura</i>		143,081	
Te ardhura të tjera			
Zhvlerësimi i aktiveve dhe investimeve financiare			
Shpenzime financiare	18	(406,011)	
<i>Shpenzime për interesa</i>		(70)	
<i>Te ardhura dhe humbje nga kembimet valutore</i>			
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>		(431,760)	
<i>Te ardhura nga kembimet valutore</i>		25,819	
Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		-	-
Fitimi/Humbja para tatimit	19	(94,459,826)	-
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	-
<i>Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin</i>			
Fitimi/Humbja e vitit	19	(94,459,826)	-
Te ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	19	(94,459,826)	-

Shefe Fiance

Rita Mishtaku
Drejtor Fiance

Olsi Shahini
Administratori


(metoda indirekte)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare	Shenime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit			
<i>Fitim / Humbja e vitit</i>		(94,459,826)	
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>		2,366,076	
<i>Konsum inventari I imet</i>			
<i>Asete të marra si grande</i>		(16,228,817)	
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>			
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>		(10,217,823)	
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>		(782,603)	
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>		264,799,516	
<i>Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit</i>		-	
<i>Tatim fitimi I paguar</i>		-	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		145,476,523	
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>		(2,328,779)	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(2,328,779)	
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
<i>Emetimi I kapitalit aksionar</i>			
<i>Pagese e detyrimeve të huave</i>		-	
<i>Interes i paguar</i>		-	
<i>Dividendë të paguar</i>		-	
Mjete monetare neto nga aktivitetin e financimit		-	
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare		143,390,873	
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		-	
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor		143,390,873	

Shefe Finace



 Rita Mishtaku

Drejtor Finace



 Olsi Shahini

Administratori



Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali I regjistruar	Diferenc e pa kaluar ne kapital ne krijim te shoqerise	Rezerva te tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015					
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël					
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					
Fitimi / Humbja e vitit					
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:					
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:					
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:					
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike					
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2016					
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:					
Fitimi / Humbja e vitit				(94,459,826)	(94,459,826)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:					
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:					
Kapitali I regjistruar	359,068,000	468,729,158			827,797,158
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike					
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	359,068,000	468,729,158	-	(94,459,826)	733,337,332

Shefe Fiance

 Rita Mishtaku

Drejtor Fiance

 Olsi Shahini

Administratori


SHENIMET SHPJEGUESE**1. Informacion i përgjithshëm**

Shoqëria “ALBGAZ” sh.a, shoqëri aksionere me kapital të regjistruar prej 359.068.000 lekë, i ndarë në 1,000 aksione me vlerë nominale 359.068 lekë/aksion, tërësisht i paguar, me seli tek Njesia Bashkiake Nr. 2, Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 3, mbrapa Ministrisë së Jashtme, Tiranë, datë themelimi më 05/01/2017, e përfaqësuar nga administrator i Shoqërisë Z. Genci GJEÇI.

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. është operimi si operator i kombinuar në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Për të realizuar këtë funksion, Shoqëria: Ushton aktivitetin si Operator i Sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes të gazit natyror, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
Euro/LEK	132.95	135.23
USD/ LEK	111.10	128.17

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndertesa	Vlera e mbetur	1.5%
Makineri e pajisje	Vlera e mbetur	2.5 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	3 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë

fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e

largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Bilanci kontabel, aktivet
4. Aktive monetare

Gjendja me 31.12.2017 e aktiveve monetare është 143,390,873 leke, e detajuar si me poshte:

Nr	Likujditete	Viti 2017	Viti 2016
1	Depozita ne banke	143,390,873	-
2	Para ne arke	-	-
	Totali	<u>143,390,873</u>	<u>-</u>

Gjendja e detajuar e bankave me 31.12.2017 është ne tabelen e meposhtme:

Nr	Llogaria bankare	Gjendja ne euro	Gjendja ne leke	Totali ne leke
1	Credins Bank		61,389,979	61,389,979
2	Raiffeisen Bank ne leke		(1,243.65)	(1,244)
2	Raiffeisen Bank ne euro	616,789.3	82,002,137	82,002,137
	Shuma	<u>616,789.3</u>	<u>143,390,873</u>	<u>143,390,873</u>

Vlerat monetare ne monedhe te huaj jane vlersuar me kursin e Bankes se Shqiperise ne date 31.12.2017 dhe diferencat kane kaluar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

5. Te drejta te arketueshme

Ne kete post paraqiten te drejta te arketueshme me 31.12.2017 ne shumen 10,217,823 leke, si me poshte:

Nr	Te drejta te arketueshme	Viti 2017	Viti 2016
1	Nga aktiviteti I shfrytezimit	9,556,494	-
a	<i>Te arketueshme nen 1 vit</i>	9,556,494	-
b	<i>Te arketueshme mbi 1 vit</i>	-	-
2	Te tjera	661,329	-
	Totali	<u>10,217,823</u>	<u>-</u>

5.1 Nga aktiviteti i shfrytezimit

Ne "Llogari / te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit " jane pasqyruar faturat e papaguara per Albpetrol sha(QASHNG gaz) gaz te transmetuar ne shumen 9,556,494 leke, me 31.12.2017.

Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periodhe afatshkurter me vleren e tyre nominale Kerkesat per arketim sipas drejtimit do te arketohen brenda vitit qe vjen. Pervec fakteve te paparashikuara kur nuk zbatohet kontrata.

5.2 Te tjera

Paraqiten kerkesa te tjera ne shumen 661,329 leke, me 31.12.2017, e cilat perfaqesojne vleren e 3 cope kompjutera (diference nga dorezimi) nga personi pergjegjes material Z.Saimir Deliallisi dhe ceshtja është akoma ne ndjekje nga organet kopetente.

6. Inventaret

Ne kete post paraqiten me 31.12.2017 inventar Lende e pare dhe materiale te konsumueshme ne shumen 782,603 leke, si me poshte:

Nr	Gjendje inventari	Viti 2017	Viti 2016
1	Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	782,603	-
	Totali	<u>782,603</u>	<u>-</u>

Gjendja materiale te konsumueshme he e lendes se pare jane te vleresuar me koston e blerjes. Gjate vitit 2017 nuk eshte ndryshuar menyra e mbajtjes se inventarit e cila vazhdon te jete me kosto mesatare.

7. Aktive afatgjata

Gjendja e e aktiveve afatgjata materiale eshte paraqitur me vlere neto me 31.12.2017 ne shumen 840,758,201 leke, si me poshte:

Nr	Aktivet afatgjata materiale	Viti 2017	Viti 2016
1	Toke dhe Ndertesa	156,677,088	-
3	Makineri e pajisje	668,562,790	-
4	Pajisje zyre te marre si grand	14,642,647	-
5	Inventar ekonomik	587,361	-
6	Asete ne magazine	288,315	-
	Totali I AA materiale	<u>840,758,201</u>	<u>-</u>

8. Aktivet jo materiale

Gjendja e aktiveve afatgjata jo materiale eshte paraqitur me vlere neto me 31.12.2017 ne shumen 2,987,348 leke

Nr	Aktivet afatgjata jomateriale	Viti 2017	Viti 2016
1	License programe dhe transmetimi	2,987,348	-
	Totali I AA jo materiale	<u>2,987,348</u>	<u>-</u>

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016.

Bilanci kontabel, Pasivet
9. Detyrimet Afatshkurtra

Ne kete post paraqitet gjendja e detyrimeve afatshkurtra me 31.12.2017 ne shumen 165,673,194 leke.

Nr	Detyrimet afatshkurtra	Viti 2017	Viti 2016
1	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimi	9,313,907	-
2	Të pagueshme ndaj punonjësve	8,117,388	-
3	Të pagueshme për detyrimet tatimore	779,469	-
4	Te tjera detyrime	147,462,430	-
	Totali I detyrimeve	<u>165,673,194</u>	<u>-</u>

8.1 Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimi

Ne kete ze eshte perfshire gjendja e furnitoreve te palikuiduar e te tjera me 31.12.2017 ne shumen 9,313,907 leke, si me poshte:

Nr	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Furnitore te papaguar	9,318,043	-
2	Debitore te tjere kreditore te tjere (428),	(4,136)	-
	Totali	<u>9,313,907</u>	<u>-</u>

8.2 Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve

Ne kete ze eshte perfshire detyrimi ndaj punonjesve dhe sigurimeve me 31.12.2017 ne shumen 8,117,388 leke, si me poshte:

Nr	Të pagueshme ndaj punonjësve	Viti 2017	Viti 2016
1	Paga personeli	6,325,015	-
2	Paga personeli	150,373	-
3	Detyrim sigurime shoq ,shendets	1,642,000	-
	Totali	<u>8,117,388</u>	<u>-</u>

8.3 Të pagueshme për detyrimet tatimore

Shuma e detyrimeve tatimore te palikuiduara deri me 31.12.2017 eshte 779,469 leke, si me poshte:

Nr	Detyrimet tatimore	Viti 2017	Viti 2016
1	TVSH	164,350	-
2	Tatim ne burim	26,537	-
3	Tatim Fitimi	588,582	-
	Totali I detyrimeve tatimore	<u>779,469</u>	<u>-</u>

8.4 Te tjera detyrime

Shuma e detyrimeve te tjera te palikuiduara deri me 31.12.2017 eshte 147,462,430 leke, si me poshte:

Nr	Te tjera detyrime	Viti 2017	Viti 2016
1	Hua nga OST	20,000,000	-
2	Hua nga Albpetrolit	127,462,430	-
	Totali I detyrimeve	<u>147,462,430</u>	<u>-</u>

10. Grante dhe te ardhura te shtyra

Paraqitet vlera e granteve me 31.12.2017 ne shumen 99,126,322 leke, e detajuar si me poshte:

Nr	Grante dhe te ardhura te shtyra	Viti 2017	Viti 2016
1	Asete te dhuruara	16,691,002	-
2	Dhurim likuiditetesh per rikonstrukcion zyresh ne Fier	82,435,320	-
	Totali	<u>99,126,322</u>	<u>-</u>

Vlera e asetëve të dhurara kanë qenë në vlerën 16,890,154 leke nga e cila shuma prej 199,152 leke është pakesuar për rimarrjen e amortizimit të asetëve të marra si grant.

Asetet e dhuruara janë pakesuar për shumën 661,329 leke, të paraqitura tek Te drejtat e arketueshme, zeri "Te tjera", e cila përfaqëson vlerën e 3 kompjuterave të vjedhur, për të cilin shoqëria po ndjek procedurat gjyqësore për arketimin e demit. Me perfundimin e procedurave për këto diferencë do të bëhet sistemimi tek zeri I granteve, shumë për të cilën ka mosperputhje me asetet e paraqitura në aktiv të bilancit.

11. Kapitali

Tabela e mëposhtme pasqyron levizjet në grupin e kapitaleve të veta të shoqërisë. Albgaz shpesh është krijuar si shoqëri aksionere Bazuar në V.K.M. Nr. 848, datë 07.12.2016, "Për krijimin e Shoqërisë "Albgaz" Sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive "Albpetrol" Sh.a. dhe "Albgaz" Sh.a.", dhe Urdhrit nr. 550/3, datë 5.5.2016, të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, "Për sistemimin e kapitalit të Albpetrol Sh.a.", Kapitali i regjistruar është 359,068,000 leke. Kapitale të veta janë pakesuar me humbjen e vitit 2017 për 94,459,826 leke. Totali i kapitaleve të veta të shoqërisë më 31.12.2017 është 733,337,332 leke.

Nr	Kapitali dhe rezervat	Viti 2017	Viti 2016
1	Kapitali I nënshkruar	359,068,000	-
2	Diferenca e pa kaluar në kapital në krijimin e shoqërisë	468,729,158	-
3	Fitime e humbje e vitit ushtrimor	(94,459,826)	-
	Totali I kapitalit	<u>733,337,332</u>	<u>-</u>

Pasqyra E Te Ardhurave Dhe Shpenzimeve

12. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Në këtë post janë regjistruar të ardhurat e realizuara nga shitja për vitin 2017 në shumën 19,208,475 leke, si më poshtë:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	19,208,475	-
	Totali I	<u>19,208,475</u>	<u>-</u>

13. Lende e pare dhe materialet e konsumueshme

Në këtë post janë përfshirë konsumi i materialeve të pasqyruara analitikisht më poshtë në shumën 1,983,955 leke:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Lende e pare dhe materiale të konsumueshme	1,931,443	-
2	Konsumi I inventarit të imet	52,512	-
	Shuma	<u>1,983,955</u>	<u>-</u>

14. Shpenzime personeli

Jane paraqitur shpenzimet e shoqerise per personelin ne shumen 92,821,412 leke si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Shpenzime per paga	81,671,006	-
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	10,481,260	-
3	Shpenzime te tjera per personelin	669,146	-
	Shuma	<u>92,821,412</u>	<u>-</u>

15. Shpenzime amortizimi

Ne kete post paraqiten shpenzime per amortizimin e AQT-ve per vitin 2017 ne shumen 2,366,076 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Amortizimi I aseteve	2,366,076	-
	Shuma	<u>2,366,076</u>	<u>-</u>

16. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Ne kete post jane te perfshira shpenzime te periudhes ne shumen 16,433,080 leke si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Shpenzime te tjera me fatura tatimore	12,961,574	-
2	Shpenzime per dieta , keshill mbikqyres e komisjone	3,471,506	-
	Shuma	<u>16,433,080</u>	<u>-</u>

17. Te ardhura te tjera

Ne kete post paraqiten te ardhura te tjera ne shumen 342,233 leke, te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Rimarje Grandesh nga amortizimi I asetve	143,081	-
2	Rimarje Grandesh per konsumin e materialeve te falaura	199,152	-
	Totali I te ardhurave	<u>342,233</u>	<u>-</u>

18. Shpenzime financiare

Ne kete post paraqiten shpenzime te tjera financiare ne shumen 406,011 leke, te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2017	Viti 2016
1	Gjoba e interesa	(70)	-
2	Humbje nga kursi I kembimit	(431,760)	-
3	Te ardhura interesat	25,819	-
	Totali	<u>(406,011)</u>	<u>-</u>

19. Llogaritja e tatim fitimit

Shoqëria për vitin ushtrimor 2017 paraqitet me humbje në shumë prej 94,459,826 leke.

Nr	EMERTIMI	Viti 2017	Viti 2016
1	Te ardhura	19,208,475	-
2	Shpenzime	(113,668,301)	-
3	Rezultati i ushtrimit	<u>(94,459,826)</u>	-
4	Shpenzime të pazbritshme <i>Gjoha, kamata, demshperblime</i>	-	-
5	Rezultati tatimor	<u>(94,459,826)</u>	-
6	Tatim fitimi	-	-
7	Fitimi / humbja neto	<u><u>(94,459,826)</u></u>	-

20. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

21. Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Shefe Finance



Rita Mishtaku

Drejtor Finance



Olsi Shahini

Administratori

